



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a dhe të nenit 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.08.2018, miratoi këtë

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01-463/03-0118225/17, DT. 22.05.2017, PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTSHME NË PRONËSI TË “AL-TRADE” SHPK

- I. Miratohet Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit 01-463/03-0118225/17, dt. 22.05.2017, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të “AL – TRADE” SHPK dhe Bajram (Nasuf) Gashanit.
- II. Sipas vendimit të cekur në pikën I, plotësim-ndryshim nënkupton:
 1. Ndryshohet pika II, nënpika 1 e vendimit, hiqet parcela kadastrale nr. 965-0, ZK Matiçan, pronë e Komunës së Prishtinës, dhe në vend të parcelës së lartcekur shtohen pjesët e parcelave nr. 466-0, ZK Zllatar dhe nr.1360-0, ZK Çagllavicë, ndërsa pikat tjera të vendimit mbetën të pandryshuara.
- III. Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit 01-463/03-0118225/17, dt. 22.05.2017, të cekur në pikën II, është bërë pasi që prona e cekur është në kontest gjyqësor.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-195033/18, më 09.08.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

